

LLAÇ MURI



PREGIPS

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
E bardhë	Thes, 25 Kg	3 m ² /thes/10 mm trashesi

PËRSHKRIM

Suva me bazë gipsi për aplikim me dorë dhe makineri. PREGIPS është një llaç i parapërgatitur, me peshe të lehtë, me përbajtje agregatësh cilesore dhe aditive specifike.

FUSHA E APLIKIMIT

PREGIPS përshtatet në mënyrë ideale mbi sipërfaqe betoni poroz, mure të ndërtuara me materiale të ndryshme me tulla poroz ose normale. Për krijimin e sipërfaqeve të lëmuara, lehtësisht të strukturueshme në mure dhe tavane për ambiente të brendshme. Suva një-shtresore për të gjitha sipërfaqet, beton si dhe sipërfaqe mbajtëse të suvat-uara më parë. Përdoret në të gjitha ambientet, nga çatia deri në bodrum me lagështi të zakonshme ajri, përfshirë kuzhinat dhe banjot. Mund të përdoret si sipërfaqe për tu përpunuar më tej me bojë ose letra murale, për tu veshur me pllaka, ose për të aplikuar suva dekorative.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike. Fugat e tullave duhet të mbyllen paraprakisht për të pasur një mbulim pa plasaritje. Në bazamentet me beton të lëmuar rekomandohet trajtimi i sipërfaqes me beton primer ndërsa në bazamentet me sipërfaqe shumë thithëse ose me pluhura rekomandohet trajtimi i sipërfaqes me astar akrilik.

PËRGATITJA E SUPORTIT


Produkti është i përshtatshëm për tu punuar me dorë dhe makineri. Përgatitja realizohet përmes një përzierje intensive në makinerinë e suvasë. Sasia e ujit që duhet është e rregulluar në mënyrë të tillë që të arrihet një konsistencë e hollë, e cila lejon të punohet në trashësinë e kërkuar pa problem mbi sipërfaqen në dispozicion. Brumi kremoz i gipsit lejon të shtyhet lehtë nga koka e pistoletës së pompës dhe krijon një shtresë suvaje të njëtrajtshme, të lehtë për tu shpërndarë.

APLIKIMI

Suvatë për makineri vendosen si rregull në trashësi shtrese nga 10 deri 35 mm. Suvaja me bazë gipsi spërkatet në masë të njëtrajtshme nëpërmjet kokës së pistoletës me presion në trashësinë e dëshiruar. Nëpërmjet presionit të spërkatjes realizohet një ngjytje më e mirë e suvasë mbi sipërfaqe, meqenëse gipsi futet thellë në fugat e sipërfaqes që do të suvatohet. Pasi materiali sprucohet, llaçi shpërndahet horizontalisht dhe vertikalisht. Me fillimin e fortësimit të shtresës, sipërfaqja tërhiqet me mastar ose mallë në mënyrë që të eliminohen disnivelet. Në rast se shtresa përfundimtare do të jetë suva dekorative apo nëse sipërfaqja do të vishet me pllaka, sipërfaqe mund të tërhiqet dhe jo të lëmohet. Pasi suvaja është fortësuar mjaftueshëm, laget pak dhe lëmohet me bërda ose me makineri lëmimi.

TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Koha e punueshmërisë: 1-2 orë
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350 kg	Trashësia minimale e aplikimit për tavane: 8 mm
Ngjyra: E Bardhe	Densiteti i llaçit të thatë: 0.95 gr/cm³
Konsumi: 3 m²/thes/10 mm trashësi	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Aplikimi i materialit: Me dorë ose makineri, 1 dorë
Koha e magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	Forca në shtypje pas 28 ditësh: ≥ 2.5N/mm²
Trashësia minimale e aplikimit për mure: 10 mm	Konduktiviteti termik: 0.34 W/mK
Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1	



Per te gjitha rastet e siperpermendura gjate fazes se punes dhe ngurtesimit te produktit, temperatura nuk duhet te jene me te ulta se +5°C dhe me te larta se +35°C. Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund te ndryshojne karakteristikat e punimit te produktit (ngadalsim ose pershpejtim ne tharje te produktit). Duhet respektuar dhe raporti i hollimit me uje te Astoreve.